



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.813/ 13 prot.

Datë 28 .04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 562 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.504/2026, datë 15.04.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

**Ankimues:** BOE Albsig Jetë, Sh.A, SIGAL Insurance Group, Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A, me NIPT-e L92019017V, J91809007H, K51423801Q, *adresa: Downtown One, Bulevardi: Bajram Curri , HQ 1010, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.  
*Adresa:Rr. Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

## *Rrethanat e çështjes*

I.1. Me vendimin Nr. 504/2026, datë 15.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE Albsig Jetë Sh.A, SIGAL Insurance Group Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group Sh.A, për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit duke kualifikuar BOE Albsig Jetë Sh.A, SIGAL Insurance Group Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group Sh.A sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Albsig Jetë, Sh.A.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 795/11 prot., datë 21.04.2026, protokolluar me tonën nr. 813/10 prot., datë 24.04.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A., njofton se në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi si dhe ka bashkangjitur shkresës, procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave” për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi.

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 795/11 prot., datë 21.04.2026, protokolluar me tonën nr. 813/10 prot., datë 24.04.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A., njofton se në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlersimin për procedurën objekt ankimi, bashkangjitur procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”

II.2. Referuar shkresës sipërcituar dhe nga verifikimi i raportit të auditit për rivlersimin e ofertave të paraqitura, Komisioni kreu verifikimet dhe konstatoi, se Autoriteti Kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit më datë 21.04.2026 sipas konstatimeve të Vendimit të KPP-së.

II.3. Për sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A. ka zbatuar vendimin Nr. 504/2026, datë 15.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

